



Tiranë më

Nr.

RELACION
PËR
PROJEKTUDHËZIMIN
PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEPOZITIMIN DHE VERIFIKIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT, AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTAVE
TË KANDIDATËVE DHE MIRATIMIN E MODELEVE TË KANDIDIMIT PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKVENDIMIT

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend.

Udhëzimi është ndarë në 11 nene si vijon:

- Neni 1 - Modelet e kandidimit

Sipas këtij neni, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve udhëzon plotësimin e dokumentacionit të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend sipas modeleve që i bashkëlidhen udhëzimit. Modelet e kandidimit përmbajnë pjesën sqaruese ku përcaktohet mënyra e plotësimit të tyre.

- Neni 2 - Dorëzimi i dokumentacionit të kandidimit

Dokumentacioni i kandidimit për zgjedhjet për Kuvend depozitohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Neni 3 - Regjistrimi i listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të propozuar nga partia politike ose koalicioni

Partia politike ose koalicioni që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, depoziton në KQZ kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për cdo zonë zgjedhore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Për regjistrimin e listës shumemërore, partia politike ose koalicioni duhet të paraqesë në KQZ, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet të nënshkruar nga kryetari i partisë,
 - b) Deklaratën e secilit prej kandidatëve të listës shumemërore për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike, sipas pikës 3, të nenit 92/2, të Kodit Zgjedhor të cilën e deklarojnë në momentin e regjistrimit të listës së kandidatëve,
 - c) Deklaratën e secilit prej kandidatëve të listës shumemërore për pranimin e kandidimit ku deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” të nenit 72, të Kodit Zgjedhor,
 - d) Sipas rastit, kopjen e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 63, të Kodit Zgjedhor depozituar dhe protokolluar pranë institucionit përkatës;
 - e) Vërtetimin e nënshkruar nga Kuvendi, ku vërtetohet zotërimi i mandatit, të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit;
 - f) Formularin tip të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin, në përputhje me nenet 68, 69 dhe 71, të Kodit Zgjedhor. Formularit tip i bashkëlidhet fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, e nënshkruar nga çdo zgjedhës,
 - g) Jetëshkrimin e kandidatëve të listës shumemërore,
 - h) Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatëve të listës shumemërore,
 - i) Formularin e vetëdeklarimit për secilin nga kandidatët e listës shumemërore,
 - j) Procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve, në momentin e depozitimit të dokumenteve të kandidimit.
- Neni 4 - Regjistrimi i kandidatit për deputet i propozuar nga zgjedhësit

Komiteti Nismëtar, që është regjistruar në KQZ për zgjedhjet për Kuvend, për të mbështetur një kandidat të propozuar nga zgjedhësit, depoziton në KQZ kërkesën për regjistrimin e kandidatit për deputet jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Për regjistrimin e kandidatit për deputet, Komiteti Nismëtar duhet të paraqesë në KQZ, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën e paraqitur nga Komiteti Nismëtar për të regjistruar kandidatin për deputet,
- b) Deklaratën e kandidatit për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike, nëse planifikon të pranojë dhurime për fushatë, bazuar në pikën 3, të nenit 92/2, të Kodit Zgjedhor,
- c) Deklaratën e pranimin të kandidimit ku të deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 72, të Kodit Zgjedhor,
- d) Deklaratën e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie

apo koalicioni dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër,

- e) Sipas rastit, kopjen e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 63, të Kodit Zgjedhor depozituar dhe protokolluar pranë institucionit përkatës;
- f) Formularin tip me nënshkrimet e zgjedhësve, emrat e të cilëve janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, të zonës zgjedhore të përcaktuar në këtë formular në përputhje me nenet 68, 70 dhe 71, të Kodit Zgjedhor. Formularit tip i bashkëlidhet fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, e nënshkruar nga çdo zgjedhës.
- g) Vërtetimin me shkrim, të nënshkruar nga Kuvendi apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit, bazuar në nenin 70/4 të Kodit Zgjedhor.
- h) Jetëshkrimin e kandidatit;
- i) Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatit;
- j) Formularin e vetëdeklarimit të kandidatit;
- k) Procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve, i cili plotësohet në momentin e depozitimit të dokumenteve të kandidimit.

- Neni 5 - Verifikimi i dokumentacionit të kandidimit të depozituar në KQZ

KQZ kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e neneve 67, 68 dhe 72, të Kodit Zgjedhor, duke ndjekur këtë radhë veprimi:

- a) Verifikon nëse subjekti parti politike/koalicion është regjistruar si subjekt zgjedhor;
- b) Verifikon nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar;
- c) Verifikon plotësimin e kushteve/kritereve të përcaktuara në dispozitat e neneve 67 deri 72, të Kodit Zgjedhor, përfshirë edhe zbatimin e kuotës gjinore;
- d) Verifikon plotësinë e dokumenteve të kandidimit dhe të nënshkrimeve;
- e) Në rast se konstatohet mosplotësimi i kushteve/kritereve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, apo mungojnë dokumente, administrata i kërkon menjëherë subjektit zgjedhor të bëjë plotësimin e dokumenteve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton ose refuzon listën e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend. KQZ kryen dhe verifikimin e listës së zgjedhësve që mbështesin listat e kandidatëve të partisë/ve politike apo koalicionit/eve të cilat nuk zotërojnë mandat në Kuvend ose zotërojnë së bashku më pak mandate se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

- Neni 6 - Verifikimi i nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët

KQZ-ja cakton një seancë publike për verifikimin e nënshkrimeve në të cilën marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar, dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore.

Administrata e KQZ-së për zgjedh në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve që mbështesin subjektin zgjedhor përkatës të kopjes së formularit tip të nënshkrimeve.

Administrata e KQZ-së verifikon nënshkrimin e kandidatëve duke përcaktuar nëse nënshkruesit janë zgjedhës me vendbanim në zonat zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të

paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

- Neni 7 - Verifikimi i formularit të vetëdeklarimit

Administrata e KQZ-së verifikon *prima facie* të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016.

Si rregull, brenda 72 orëve nga dorëzimi i formularëve të vetëdeklarimit, administrata e KQZ-së evidenton rastet e refuzimit apo të mosparaqitjes së formularit të vetëdeklarimit. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për refuzimin e regjistrimit të kandidatit në zgjedhje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në varësi të rezultatit të verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit, administrata i paraqet për miratim Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, projektaktin përkatës, sipas përcaktimeve në nenin 10, të ligjit nr.138/2015.

- Neni 8 - Kthimi për plotësim dhe miratimi i dokumentacionit zgjedhor

KQZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe, nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së zgjedhjeve.

Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.

Administrata e KQZ-së, si rregull, jo më vonë se 24 orë nga ridepozitimi, verifikon dokumentacionin e plotësuar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit të kandidimit, jo më vonë se 24 orë.

- Neni 9 - Vendosja e sanksioneve

Mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në Kodin Zgjedhor, sipas të cilit, për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend një në çdo tre emra të kandidatëve të listës shumëmemërore me renditje të fiksuar i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës shumëmemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar, passjell refuzimin e regjistrimit të listës.

- Neni 10 - Afatet për publikimin e listës së kandidatëve

Pas mbarimit të afatit të ankimimeve në Kolegjin Zgjedhor, KQZ-ja publikon listën e plotë të kandidatëve në faqen e saj zyrtare në internet.

Një kopje e listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet Prefektit, Këshillit të Qarkut dhe KZAZ-ve. Prefekti dhe Këshilli i Qarkut e publikojnë listën e kandidatëve të zonës zgjedhore në mediat vendore që kanë mbulimin më të gjerë me sinjal në qark si dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre. KZAZ-të përkatëse, menjëherë pas marrjes së listës shumëmemërore nga KQZ-ja, i afishojnë në hyrjen e selisë së tyre.

- Neni 11 - Dispozita të fundit

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e madeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend”.

Pavlina DOÇAJ

- Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: .2025

Nr: 00

Ora: 00:00

PROJEKTUDHËZIM

PËR

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEPOZITIMIN DHE
VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT, AFATET PËR
PUBLIKIMIN E LISTAVE TË KANDIDATËVE DHE MIRATIMIN E
MODELEVE TË KANDIDIMIT PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, 64, pika 2, shkronja “e”, 67, 68, 69, 71, 72, 73, dhe 92/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të vendimit të Kuvendit, nr.17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”

UDHËZOJ:

Neni 1

Modelet e kandidimit

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve udhëzon plotësimin e dokumentacionit të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend sipas modeleve:
 - a) Formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati, Model KQZ - 04-01;
 - b) Deklarata e angazhimit solemn e kryetarit të partisë politike, Model KQZ-04-02;
 - c) Deklaratë për hapje llogarie të posaçme bankare të partisë politike Model KQZ-04-03;
 - d) Kërkesë për regjistrimin e Komitetit Nismëtar, Model KQZ-04-04;
 - e) Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, Model KQZ-04-05;
 - f) Kërkesë për regjistrimin e listës shumemërore për deputet propozuar nga parti politike/koalicion, Model KQZ-04-06;
 - g) Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme, Model KQZ-04-07;
 - h) Deklaratë për pranimin e kandidimit, Model KQZ-04-08;
 - i) Jetëshkrimi i kandidatit, Model KQZ-04-09;

Data: xx.xx.2025 Nr:
Ora: xx:xx



Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend

- j) Procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit Model KQZ -00-21.
2. Modelet e kandidimit përmbajnë pjesën sqaruese ku përcaktohet mënyra e plotësimit të tyre.
3. Modelet e kandidimit pasqyrohen në shtojcën që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Neni 2

Dorëzimi i dokumentacionit të kandidimit

Dokumentacioni i kandidimit për zgjedhjet për Kuvend depozitohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Neni 3

Regjistrimi i listës shumemrore të kandidatëve për deputet të propozuar nga partia politike ose koalicioni

1. Partia politike ose koalicioni që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, depoziton në KQZ kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për cdo zonë zgjedhore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Partia politike ose koalicioni për regjistrimin e listës shumemërore duhet të paraqesin, në KQZ, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet të nënshkruar nga kryetari i partisë, sipas Modelit KQZ-04-06;
 - b) Deklaratën e secilit prej kandidatëve të listës shumemërore për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike, sipas pikës 3, të nenit 92/2, të Kodit Zgjedhor të cilën e deklarojnë në momentin e regjistrimit të listës së kandidatëve, sipas Modelit KQZ-04-07;
 - c) Deklaratën e secilit prej kandidatëve të listës shumemërore për pranimin e kandidimit ku deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” të nenit 72, të Kodit Zgjedhor sipas Modelit KQZ-04-08;
 - d) Sipas rastit, kopjen e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 63, të Kodit Zgjedhor depozituar dhe protokolluar pranë institucionit përkatës;
 - e) Vërtetimin e nënshkruar nga Kuvendi, ku vërtetohet zotërimi i mandatit, të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit;
 - f) Formularin tip të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin, në përputhje me nenet 68, 69 dhe 71, të Kodit Zgjedhor sipas modelit Model KQZ-04-01. Formularit tip i bashkëlidhet fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, e nënshkruar nga çdo zgjedhës;
 - g) Jetëshkrimin e kandidatëve të listës shumemërore sipas Modelit KQZ-04-09;
 - h) Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatëve të listës shumemërore;
 - i) Formularin e vetëdeklarimit për secilin nga kandidatët e listës shumemërore;
 - j) Procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve sipas Modelit KQZ-00-21, në momentin e depozitimit të dokumenteve të kandidimit.
3. Kërkesa referuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, nënshkruhet nga kryetari i partisë apo kryetari i partisë udhëheqëse të koalicionit në rastin kur koalicioni është regjistruar si subjekt zgjedhor.

Neni 4

Regjistrimi i kandidatit për deputet i propozuar nga zgjedhësit

1. Komiteti Nismëtar, që është regjistruar në KQZ për zgjedhjet për Kuvend, për të mbështetur një kandidat të propozuar nga zgjedhësit, depoziton në KQZ kërkesën për regjistrimin e kandidatit për deputet jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Komiteti Nismëtar për regjistrimin e kandidatit për deputet duhet të paraqesë në KQZ, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesën e paraqitur nga Komiteti Nismëtar për të regjistruar kandidatin për deputet, sipas Modelit KQZ-04-05;
 - b) Deklaratën e kandidatit për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike, nëse planifikon të pranojë dhurime për fushatë, bazuar në pikën 3, të nenit 92/2, të Kodit Zgjedhor, sipas Modelit KQZ-04-07;
 - c) Deklaratën e pranimit të kandidimit ku të deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 72, të Kodit Zgjedhor, sipas Modelit KQZ-04-08;
 - d) Deklaratën e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër, sipas Model KQZ-04-08;
 - e) Sipas rastit, kopjen e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 63, të Kodit Zgjedhor depozituar dhe protokolluar pranë institucionit përkatës;
 - f) Formularin tip me nënshkrimet e zgjedhësve, emrat e të cilëve janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë , të zonës zgjedhore të përcaktuar në këtë formular në përputhje me nenet 68, 70 dhe 71, të Kodit Zgjedhor, sipas Modelit KQZ-04-01. Formularit tip i bashkëlidhet fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, e nënshkruar nga çdo zgjedhës
 - g) Vërtetimin me shkrim, të nënshkruar nga Kuvendi apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit, bazuar në nenin 70/4 të "Kodit Zgjedhor.
 - h) Jetëshkrimin e kandidatit sipas Modelit KQZ-04-09;
 - i) Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatit;
 - j) Formularin e vetëdeklarimit të kandidatit;
 - k) Procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve, i cili plotësohet në momentin e depozitimit të dokumenteve të kandidimit, sipas Modelit KQZ-00-21.

Neni 5

Verifikimi i dokumentacionit të kandidimit të depozituar në KQZ

1. KQZ kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e neneve 67, 68 dhe 72, të Kodit Zgjedhor, duke ndjekur këtë radhë veprimi:
 - a) Verifikon nëse subjekti parti politike/koalicion është regjistruar si subjekt zgjedhor;
 - b) Verifikon nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar;
 - c) Verifikon plotësimin e kushteve/kritereve të përcaktuara në dispozitat e neneve 67 deri 72, të Kodit Zgjedhor, përfshirë edhe zbatimin e kuotës gjinore;
 - d) Verifikon plotësinë e dokumenteve të kandidimit dhe të nënshkrimeve;

- e) Në rast se konstatohet mosplotësimi i kushteve/kritereve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, apo mungojnë dokumente, administrata i kërkon menjëherë subjektit zgjedhor të bëjë plotësimin e dokumenteve.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton ose refuzon listën e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend.
 3. KQZ përveç verifikimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, kryen dhe verifikimin e listës së zgjedhësve që mbështesin listat e kandidatëve të partisë/ve politike apo koalicionit/ëve të cilat nuk zotërojnë mandat në Kuvend ose zotërojnë së bashku më pak mandate se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

Neni 6

Verifikimi i nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët

1. KQZ-ja cakton një seancë publike për verifikimin e nënshkrimeve në të cilën marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar, dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore.
2. Në datën dhe orën e përcaktuar nga KQZ-ja për zhvillimin e seancës, administrata e KQZ-së disponon një kopje të formularit tip të plotësuar nga nënshkrimet mbështetëse.
3. Administrata e KQZ-së përzgjedh në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve që mbështesin subjektin zgjedhor përkatës të kopjes së formularit tip të nënshkrimeve.
4. Administrata e KQZ-së verifikon nënshkrimin e kandidatëve duke përcaktuar nëse nënshkruesit janë zgjedhës me vendbanim në zonat zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.
5. Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur.
6. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

Neni 7

Verifikimi i formularit të vetëdeklarimit

1. Administrata e KQZ-së verifikon *prima facie* të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016.
2. Administrata e KQZ-së, si rregull, brenda 72 orëve nga dorëzimi i formularëve të vetëdeklarimit, evidenton rastet e refuzimit apo të mosparaqitjes së formularit të vetëdeklarimit. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për refuzimin e regjistrimit të kandidatit në zgjedhje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
3. Në varësi të rezultatit të verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit, administrata i paraqet për miratim Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, projektaktin përkatës, sipas përcaktimeve në nenin 10, të ligjit nr.138/2015.
4. Vendimi për refuzimin e regjistrimit të kandidatit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i njoftohet, menjëherë, subjektit zgjedhor, ose kandidatit të propozuar nga zgjedhësit.
5. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për refuzimin e regjistrimit përmban dhe

sqarimin për të drejtën e subjektit për zëvendësimin e kandidaturës, jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë para datës së zgjedhjeve.

Neni 8

Kthimi për plotësim dhe miratimi i dokumentacionit zgjedhor

1. KQZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe, nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së zgjedhjeve.
2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.
3. Administrata e KQZ-së, si rregull, jo më vonë se 24 orë nga ridepozitimi, verifikon dokumentacionin e plotësuar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit të kandidimit, jo më vonë se 24 orë.

Neni 9

Vendosja e sanksioneve

Mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend një në çdo tre emra të kandidatëve të listës shumemërore me renditje të fiksuar i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës shumemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar, passjell refuzimin e regjistrimit të listës.

Neni 10

Afatet për publikimin e listës së kandidatëve

1. Pas mbarimit të afatit të ankimimeve në Kolegjin Zgjedhor, KQZ-ja publikon listën e plotë të kandidatëve në faqen e saj zyrtare në internet.
2. Një kopje e listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet Prefektit, Këshillit të Qarkut dhe KZAZ-ve. Prefekti dhe Këshilli i Qarkut e publikojnë listën e kandidatëve të zonës zgjedhore në mediat vendore që kanë mbulimin më të gjerë me sinjal në qark si dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre. KZAZ-të përkatëse, menjëherë pas marrjes së listës shumemërore nga KQZ-ja, i afishojnë në hyrjen e selisë së tyre.

Neni 11

Dispozita të fundit

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI